**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UNIVERSITETI I TIRANËS**
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**
**DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**

# PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
## Letërsi e Gjuhës Franceze

**Ngarkesa**: 4kredite; 40 orë mësimore; Letërsi e Gjuhës Frënge (20 lek/20 sem.);
**Viti** / Semestri : Viti III, semestri II
**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme
**Programi i studimit:** Bachelor në Gjuhë Franceze ’Gjuhë dhe Komunikim ‘’
**Kodi i lëndës:**Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT**:

***Objektivat e përgjithshme lëndore*:** Ky kurs synon t’ju paraqesë studentëve parimet e estetikës dhe poetikës së shkollës realiste të shekullit XIX si dhe drejtimet e ndryshme e shkollat letrare që lulëzuan gjatë shekullit XX. Lënda është e organizuar në dy module: në gjysmën e parë të semestrit ajo i njeh studentët me prozën realiste franceze të shekullit XIX, kushtet e lindjes dhe të zhvillimit të romanit realist me variantet e ndryshme të tij; në pjesën e dytëparaqiten shkollat e ndryshme letrare qënjohu romani francez duke nisur nga fillimi i shekullit XX, si trashëgimi e realizmit deri te romani postmodern e ai mitologjik duke kaluar sigurisht nga romani i absurdit dhe eksperimentet e Romanit të Ri.

***Objektivat specifike lëndore*:**

1.Ajo synon t’i iniciojë studentët njëkohësisht në analizën e veprave më të shquara letrare që shenjuan këtë shekull, përmes përfaqësuesve më të shquar të prozës së shekullit XIX dhe XX.

2.Kjo lëndë i pajis ata me teknika të analizës së teksteve dhe intertekstualitetit si dhe i njeh me një qasje krahasimore që u lejon të kuptojnë evoluimin e romanit francez dhe të formav endryshme të tij.

3. Studentët aftësohen për të përgatitur dhe paraqitur minipunime mbi veprëne njëautori të përzgjedhur nga ata vetë.